



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 53 prot.

Kamëz, më 27.04.2024

V E N D I M
Nr. 42 Datë 27.04 2024
M B I

**“VENDOSJEN E TARIFËS USHQIMORE TË FËMIJËVE NË KOPSHTE DHE
ÇERDHE SI DHE PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE PËRFITUESE TË SHËRBIMIT
USHQIMOR PA PAGESË”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.04.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.35 Datë 18.04.2024 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e vendosjes së tarifës ditore ushqimore për fëmijët në kopshte dhe çerdhe:
 - a. 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) lekë për fëmijë në kopshte;
 - b. 130 (njëqind e tridhjetë) lekë për fëmijë në çerdhe.
2. Përlllogaritja e detyrimit mujor përbëhet nga tarifa për ushqim, e cila përlllogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe/kopësht gjatë një muaji.
3. Për fëmijët e regjistruar për herë të parë kryhet një pagesë paraprake në shumën prej 5 000 lekë, në formën e garancisë. Kjo shumë i rikthehet familjeve me përfundimin e periudhës së trajtimit në këto institucione dhe pasi janë kryer verifikimet se nuk kanë detyrime të papaguara.
4. Të miratojë dhënien e shërbimit pa pagesë në kopshte dhe çerdhe për kategoritë e fëmijëve të cilët mund të përfitojnë, si më poshtë:
 - a. Fëmijë me statusin e jetimit;
 - b. Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit;
 - c. Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- d. Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike apo me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor;
 - e. Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
 - f. Fëmijë të familjeve mono prindërore;
 - g. Fëmijët e familjeve, ku kujdestari ligjor i fëmijës, është i divorcuar ose i ve, (sipas certifikatës së gjendjes familjare), vërtetuar me dokumentacionin përkatës;
 - h. Fëmijët të familjeve të pakicës rome dhe egjiptiane, sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga organizatat që mbrojnë të drejtat tyre ose vetë deklarimit ku përcaktohet se familja është pjesë e këtyre pakicave;
 - i. Fëmijët e vendosur në kujdestari nga familjet kujdestare, sipas legjislacionit në fuqi, vërtetuar me dokumentacionin përkatës;
 - j. Fëmijë të familjeve me pamundësi ekonomike.
5. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit; Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit; Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale.
6. Vendimi nr. 06, datë 10.02.2021 “Mbi vendosjen e tarifës ushqimore të fëmijëve në kopshte dhe çerdhe me ushqim dhe shërbimin pa pagesë për familjet në nevojë”, shfuqizohet.
7. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

